



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E PEJËS
MUNICIPALITY OF PEJA
OPŠTINA PEČ



ZYRA E PROKURIMIT KOMUNA E PEJËS

Njesia e Prokurimit

Peje, datë, 04.09.2024

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Pejes, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L- 237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës **30.08.2024** me titull **Hartimi i Projekti kryesor i objektit Administrativ Komunal -Peje** Nr. të Prok: **635-24-6877-4-2-3** dhe nr i brendeshen **635-24-045-423** nxjerr:

V E N D I M

Refuzohet – kërkesa për ri-shqyrtim të Operatori Ekonomik **ME CODIN 1610**. . të datës **30.08.2024** lidhur me aktivitetin e prokurimit **Hartimi i Projekti kryesor i objektit Administrativ Komunal -Peje** Nr. të Prok: **635-24-6877-4-2-3** dhe nr i brendeshen **635-24-045-423** nxjerr: kundër **B58 NJOFTIM MBI VENDIMIN E AK FAZA E PARE** , të datës **26.08.2024** të publikuar në platformën elektronike të E- Prokurimit .

Vërtetohet vendimi i A.K mbi **B58 NJOFTIM MBI VENDIMIN E AK FAZA E PARE** të publikuar me datë: **26.08.2024**

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik **ME CODIN 1610** me datën **30.08.2024** , ka parashtruar kërkesën për Ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull Prok: **Hartimi i Projekti kryesor i objektit Administrativ Komunal -Peje** me Nr. të Prok: **635-24-6877-4-2-3** nr i **635-24-045-423** nxjerr:

Autoriteti Kontraktues , me datën **04.09.2024** ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

A.K respektivisht **Juria profesionale (komisioni vlersues)** pas analizes se kerkeses se juaj për **Ri-shqyrtim** duke marr për bazë kërkesën tuaj në platformën elektronike të datës: **30.08.2024** ,e ka trajtuar me kujdes kërkesën tuaj, dhe ka ardhur në përfundim se njejtja është e **pa bazuar.**,

Fillimisht ju njoftojm se ne si AK dhe Juria profesionale (komisioni vlersues) ka shqyrtuar me vemendien kerkesen e juaj.

Pas shqyrtimit të detajuar të ankesës tuaj lidhur me vlerësimin e propozimeve për projektin "Objekti Administrativ Komunal - Komuna e Pejës", dëshirojmë t'ju informojmë për se:

Komisioni vlerësues ka shqyrtuar me kujdes të gjitha pretendimet tuaja lidhur me propozimet e paraqitura nga operatorët ekonomikë me kodet 1620 dhe 3345. Pas këtij shqyrtimi, është konstatuar se pretendimet e paraqitura nuk perbejne ndryshime bazike te projektit , dhe projektetet e propozuara nuk ndryshojn ne funksion te pergjitheshem nga detyra projektuese.

Në përputhje me nenin 59 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, ju informojmë se devijimet teknike të përmendura nuk kanë ndikim të rëndësishëm në cilësinë thelbësore të tenderit të paraqitur dhe nuk përbëjnë shkelje që do të kërkonte rishikim ose anulim të ofertave të vlerësuara si fituese.

Komisioni vlerësues ka vlerësuar se ofertat e dorëzuara nga operatorët ekonomikë me kodet 1620 dhe 3345 përmbushin kërkesat kryesore të përcaktuara në dokumentacionin e tenderit dhe janë në përputhje me standardet dhe kriteret e vlerësimit të përcaktuara.

Duke u bazuar në arsyetimet e mësipërme, ankesa juaj është vlerësuar si e pabazuar dhe për këtë arsye është refuzuar.

Ju faleminderit për mirëkuptimin dhe për angazhimin tuaj në këtë proces prokurimi.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thane me lartë ka vendosur si ne dispozitiv Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP- se duhet te dorezohet brenda afatit ligjor .

Me respekt
Zyra e Prokurimit KK Peje dhe Antaret Vlersues te Projektit

Vendimi i dorëzohet:

1. Një (1) kopje ngarkohet për mes platformës elektronike
2. Një (1) kopje – Arhivës A.K Komuna e Pejës.